



Ofertë për Shërbime të Auditimit N.P.L. “Stacioni i Autobusave” Sh.A. Therandë



Përmbajtja

Për Baker Tilly Kosovo	4
Për Baker Tilly International	5
Metodologjia jonë e Auditimit	7
Angazhimi për Vlerat	10
Ekipi Ynë.....	11
Informacione të hollësishme në lidhje me ekipin.....	13
Përvoja jonë	25
Shërbimet që do të ofrohen	26
Koha	27
Tarifat e propozuara.....	28
Shërbimet Tona	29
Klientët tanë	31
Referencat	35
Kredencialet	42

14 Prill 2016

N.P.L. “Stacioni i Autobusave” Sh.A.

Therandë, Kosovë

Re: Auditimi i pasqyrave Financiare

Baker Tilly Kosovo ka kënaqësinë të ofroj këtë propozim për të kryer Auditimin e jashtëm të Pasqyrave Financiare për N.P.L. “Stacioni i Autobusave” Sh.A. në Therandë.

Ne do të kryejmë auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe ligjeve dhe rregulloreve të zbatueshme.

Në propozimin e bashkangjitur, ne kemi përcaktuar njohurinë tonë për kërkesat tuaja dhe qasjen tonë në shërbimet e propozuara të auditimit.

Në pritje për të ju ofruar shërbimet,

Sinqerisht,

Baker Tilly Kosovo
Lulzim Berisha, Statutory Auditor
Partner

Për Baker Tilly Kosovo

Baker Tilly Kosovo është një firmë e kontabilitetit dhe konsultimeve për biznese, që ofron shërbime të auditimit, tatimeve, dhe shërbime të tjera këshilluese për bizneset.

Fillimisht firma u krijua si një biznes individual në vitin 2002 nga njëri nga partnerët tanë, Bashkim Uka. Në vitin 2008, kompania u rrit me partnerët shtesë dhe emri u ndryshua në BU & Partners. Në qershor 2012, BU & Partners u bë një anëtar i pavarur i Baker Tilly International dhe e ndërroi emrin në Baker Tilly Kosovo.

Sot, firma është një nga firmat kryesore të kontabilitetit në Kosovë, duke siguruar auditim dhe shërbime të kontabilitetit, taksave dhe konsulence biznesi të organizatave në baza kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ekipi ynë përbëhet nga profesionistë me përvojë, duke përfshirë ekspertë të taksave, auditorë të licencuar, dhe një ekip mbështetës profesional të kualifikuar në administrim biznesi, kontabilitetit dhe financa.

Angazhimi ynë për përsosmëri është i ilustruar me vëmendje të personalizuar që ne ju ofrojmë klientëve tanë; përdorimin e burimeve më të mira profesionale dhe të teknologjisë së lartë për të ofruar shërbime me kohë dhe me qmime të përballueshme.

Baker Tilly Kosovo është e zotuar ndaj integritetit dhe objektivitetit dhe ruan vlerat në mënyrë rigorozë.

Baker Tilly Kosovo është firmë me bazë në Kosovë me zyra në Prishtinë. Firma është e licencuar si firmë e auditimit nga Këshilli i Raportimit Financiar të Kosovës dhe vepron ligjërisht në Republikën e Kosovës.

Baker Tilly Kosovo aktualisht ka katër partnerë, një menaxher, një zyrtar të lartë dhe shtatë bashkëpunëtorë. Dy partnerë janë të angazhuar në detyra të auditimit të jashtëm dhe dy të tjerët në shërbime këshilluese të biznesit. Menaxheri, zyrtari senior dhe bashkëpunëtorët bazuar në përvojën e tyre dhe kompetencën, janë të caktuar në departamente të ndryshme të firmës.

Certifikata jonë e regjistrimit të kompanisë, certifikata tatimore dhe certifikatat e kualifikimit të firmës janë paraqitur në pjesën "Kredencialet" të këtij dokumenti.

Për Baker Tilly International

Baker Tilly International është njëra nga rrjetet kryesore të firmave të pavarura të kontabilitetit, auditimit dhe këshillave biznesore të bashkuara për të ofruar shërbime cilësore të klientët.

Të ardhurat e kombinuara nga firmat anëtare	US\$3.6bn
Firmat anëtare	154
Shtete	133
Të punësuar	27,000+
Partnerë	2,600+
Zyra	693

Ajo që ne përqendrohemi

- Drejtimi në mënyrë shembullore
- Ofrim i shërbimeve cilësore me një theks të veçantë mbi integritetin
- Të hapur dhe të ndershëm në të gjitha komunikimet
- Veprojmë me etikë
- Promovojmë punën në ekip dhe bashkëpunojmë me firmat tjera anëtare
- Ruajmë një mjedis mbështetës në të cilin individët mund të përparojnë

Qeverisja

Nga struktura e Baker Tilly International përfitojnë edhe klientët kombëtar edhe ata ndërkombëtar pasi që kanë fleksibilitet të operojnë si një firmë me fuqinë dhe aftësinë e një organizate globale. Baker Tilly International është një rrjet i firmave të pavarura anëtare në përkufizimin e rrjetit të dhënë nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve dhe siç është përcaktuar në Direktivën e 8 Evropiane.

Rrjeti është i udhëhequr nga vetë firmat, ku secila firmë e pavarur ka të drejta të plota të votimit.


Baker Tilly International Limited është kompani me bazë në Mbretërinë e Bashkuar e kufizuar me garanci dhe është:

- Një organizatë e cila vetë nuk ofron shërbime ndaj klientëve
- Menaxhohet nga bordi i drejtorëve ndërkombëtar dhe katër këshilltar regjional këshilldhënës që zgjedhen nga anëtarët
- Administrohet nga ekipi në zyrën qendrore
- Financohet përmes bazës jo-fitimprurëse nga firmat anëtare
- Në komunikim të rregullt me firmat anëtare për të identifikuar mundësitë e reja për të shtuar vlerë për klientët në mbarë botën.

Një organizatë e tillë e udhëhequr nga anëtarësia rezulton me pjesëmarrje me entuziazëm për të ndarë njohuritë, aftësitë dhe burimet me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve ndaj klientëve kombëtar dhe ndërkombëtar.

Struktura organizative

Baker Tilly Kosovo



Metodologjia jonë e Auditimit

Baker Tilly Kosovo është e përkushtuar për të ofruar shërbime të auditimit me cilësi të lartë. Si një firmë e pavarur e auditimit, ne kemi zhvilluar dhe zbatuar procedurat e kontrollit të cilësisë në çdo fazë të një angazhimi.

Baker Tilly Kosovo shfrytëzon metodologjinë e auditimit MERCIA™ për të siguruar kontrolle rigoroze dhe të cilësisë së pavarur.

Qasja e bazuar në rrezik e përdorur nga firma jonë përbëhet nga katër faza kryesore.

Faza e Planifikimit

Ne do të takohemi me përfaqësues të menaxhimit të organizatës për të fituar një kuptim të entitetit për të planifikuar dhe kryer vlerësim paraprak të kontrolleve dhe procedurave të brendshme. Duke përdorur qasjen e bazuar në rrezik ne do të identifikojmë fushat me rreziqe më të mëdha të anomalive materialeve. Ne do të përdorim procedurat e tilla si intervista të menaxhimit, vëzhgimit, inspektimit dhe procedurat analitike. Rezultatet e këtyre procedurave do të na udhëzojnë për të përcaktuar strategjinë e auditimit dhe identifikimin e çështjeve të rëndësishme të kontabilitetit.

Objekti është për të fituar një kuptim të organizatës dhe mjedisit që vepron me qëllim të zhvillimit të hapave të punës së auditimit sipas rezultateve të aplikueshme të operacioneve, kontrolleve të brendshme dhe të punës së auditimit.

Planifikimi i angazhimit do të marrë parasysh:

- Vendin e kryerjes së auditimit
- Takimet fillestare dhe përgatitore, për të diskutuar orarin, planifikimin, raportimin dhe kryerjen e detyrës
- Planifikimi i aktiviteteve, plani i auditimit dhe programet e punës së auditimit
- Kuptimi i kontekstit të angazhimit dhe entitetit si dhe procedurave të vlerësimit të rrezikut
- Materialiteti dhe vlersimi I rrezikut

Kryerja e Auditimit

Vlerësimi i kontrolleve të brendshme dhe të jashtme

Ne do të përftojme njohuri për mjedisin e entitetit dhe kontrollet e saja të brendshme dhe të jashtme për të vlerësuar rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, si dhe të dizajnojmë natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit. Vlerësimi I kontrollit tonë do të përfshijë:

- Hartimi dhe zbatimi i kontrolleve të entitetit
- Testimi i efektivitetit operativ të kontrolleve të zgjedhura
- Vlerësimi i rrezikut të kontrollit dhe rrezikut të anomalive të rëndësishme

Procedurat e vlerësimit të rrezikut

- Bisedat me menaxhmentin dhe të tjerët brenda entitetit
 - Kërkesat drejtuar atyre të ngarkuar me qeverisje, departamentit të auditimit të brendshëm, të punësuarit, avokatët
- Procedurat analitike

- Procedurat analitike do të përdoren në identifikimin e transaksioneve apo ngjarjeve të pazakonta, vlerave, raporteve si dhe tendencave që mund të tregojnë çështjet që kanë të bëjnë me pasqyrat financiare dhe implikime në auditim.
- Vëzhgimi dhe inspektimi
 - Vëzhgimi i aktiviteteve të entitetit dhe operacioneve, inspektimi i dokumenteve, leximi i raporteve menaxheriale, vizita në lokacionet dhe aktivitetet e entitetit, gjurmimi i transaksioneve nëpërmjet sistemit të informacionit.

Testimi Thelbësor

Pas planifikimit të procedurave thelbësore ne do të testojmë objektivat e auditimit duke përdorur procedurat analitike, testet e detajeve, si dhe procedurat thelbësore për të testuar çdo rrezik të mashtimit që ne kemi identifikuar.

Hapat të tjerë në këtë fazë do të përfshijnë

Marrja në konsideratë e karakteristikave të klasave të transaksioneve, llogarive apo shpalosjeve.

Procedurat specifike

Lista e Procedurave për t'u zbatuar gjatë angazhimit në projekt

- Auditori arrin një kuptim të termave dhe kushteve të Marrëveshjes për Grant duke rishikuar
- Statusi ligjor dhe i TVSH-së i përfituesit dhe bashkë-përfituesve
- Raporti Përfundimtar Financiar duhet të jetë konform me modelin në Shtojcën IV të Marrëveshjes për Grant
- Rregullat për Kontabilitet dhe Mbajtja e Regjistrave
- Kurset e këmbimit
- Procedurat për verifikimin e përputhjes së shpenzimeve me rishikimin e buxhetit dhe rishikimin analitik
 - Auditori kryen rishikim të pavarur për titujt e shpenzimeve në Raportin Përfundimtar Financiar;
 - Auditori verifikon sa mos janë bërë amandamentime në buxhetin e Marrëveshjes për Grant;
 - Auditori verifikon që buxheti nga Raporti Përfundimtar Financiar korrespondon me buxhetin nga Marrëveshja për Grant (autenticiteti dhe autorizimi i buxhetit fillestar) dhe që shpenzimet e shkaktuara janë shënuar në buxhetin e Marrëveshjes për Grant;

Auditori verifikon çfarëdo transferi ndërmjet titujve të buxhetit duke krahasuar buxhetin fillestar me buxhetin në Raportin Përfundimtar Financiar dhe kontrollon se a është punuar në përputhje me dispozitat e Nenit I.4.4 të Marrëveshjes për Grant.

Përfundimi i Auditimit dhe Raportimi

Ne do të kryejmë vlerësimin e përgjithshëm të dëshmive të auditimit që kemi përfutur dhe do të vlerësojmë përshtatshmërinë dhe mjaftueshmërinë e tyre për secilën objektive të auditimit për të zvogëluar rrezikun e anomalive materiale.

Dokumentimi dhe dëshmitë e auditimit mbështeten në procesin si në vijim:

- Dokumentimi dhe letrat e punës
- Evidencat e auditimit
- Letra e përfaqësimit
- Procedurat e Auditimit
- Rishikimi I cilësisë

Rishikimi i Sigurisë së Cilësisë

Si një firmë e pavarur e auditimit ne kemi zhvilluar dhe ne jemi duke zbatuar procedurat e kontrollit të cilësisë në cdo fazë të një angazhimi.

Baker Tilly Kosovo shfrytëzon metodologjinë e auditimit MERCIA™ për të siguruar auditime cilësore.

Firma jonë ka të vendosura procedura për të siguruar se janë mbledhur dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit përmes inspektimit, bisedave dhe konfirmimit për të na ofruar bazë të arsyeshme për opinionin e pasqyrave financiare. Procedurat tona do të sigurojnë që:

- Raportet e auditimit dhe letrat mbështetëse të punës janë shqyrtuar si duhet nga njëri nga partnerët;
- Të gjitha sasi të dhe shumat monetare që përfshijnë llogaritjet përmbajnë referenca të duhura në dokumentet përkatëse; dhe
- Të gjitha deklaratat faktike, numrat, përfundimet dhe shumat monetare janë të indeksuara me letrat mbështetëse të punës.

Angazhimi për Vlerat

Sigurimi i Cilësisë

Si një firmë e pavarur e auditimit ne kemi zhvilluar dhe zbatuar procedurat e kontrollit të cilësisë në përputhje me Standardin Ndërkombëtar për Kontrollin e Cilësisë (ISQC) 1 në çdo fazë të një angazhimi.

Pavarësia

Sistemi ynë i sigurimit të cilësisë kërkon që çdo partner, senior apo staf të ruajë objektivitetin dhe pavarësinë në çdo detyrë të angazhuar. Ne kemi vendosur procedura të cilat sigurojnë se i gjithë personeli shpalosë çfardo çështje që mund të komprometojë pavarësisë qoftë për shkak të interesit financiar ose ndonjë interesi personal.

Konfidencialiteti

Procedurat tona të brendshme janë të qarta për të gjithë personelin tonë marrëdhënia klient-auditor mbetet konfidenciale gjatë dhe pas angazhimeve. Personeli i lejohet të diskutojë çështjet përkatëse të angazhimit vetëm me partnerët e angazhuar.

Zhvillimi i Vazhdueshëm

Si pjesë e profesionit me ndryshime të vazhdueshme në standardet e raportimit financiar dhe auditimit, të gjithë partnerëve dhe stafit tonë u kërkohet të mbajnë kompetencat dhe aftësitë e tyre përmes trajnimeve formale dhe trajnimeve në vendin e punës. Ne sigurojmë se kompetenca e personelit tonë është e azhurnuar duke zbatuar strategji strikte të zhvillimit të vazhdueshëm.

Ekipi Ynë

Ekipi i Baker Tilly Kosovo përbëhet nga auditorë të licencuar dhe kontabilistë, me përvojë të gjerë në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), Standardet e Kontabilitetit të Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Kompetenca dhe integriteti ynë siguron cilësi të lartë të shërbimeve të ofruara për klientët. Auditorët tonë janë ndër auditorët e parë të licencuar në Kosovë. Ekipi ynë sjell njohuri të gjerë të administrimit financiar publik dhe privat. Ekipi ynë është ekipi i parë që ka punuar në Sigurimin e Cilësisë të Auditimit siç kërkohet nga IFAC. Është ekipi ynë që ka zhvilluar një program trajnimi për profesionin e kontabilitetit në Kosovë dhe menaxhimit financiar në sektorin publik.

Si anëtarë të Shoqatës së Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (SHKÇAK), një anëtare e plotë e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK) ne jemi të detyruar të mbajmë standardet më të larta profesionale dhe etike.

Ekipi i zgjedhur më poshtë është i bazuar në përvojën e tyre profesionale në ofrimin e shërbimeve të ngjashme për organizatat apo projektet.

Lulzim Zeka - Partner

Zeka është auditor i licencuar dhe kontabilist i certifikuar sipas rregulloreve të Kosovës, ai ka më shumë se dhjetë vjet përvojë në fusha të lidhura me kontabilitetin. Zeka mban diplomën Master i Shkencës në Kontabilitet nga W.P. Carey School of Business of Arizona State University. Zeka është një nga partnerët e auditimit të firmës që udhëheq angazhimet e auditimit për disa klientë jo-fitimprurës në industri të ndryshme dhe klientë fitimprurës. Ai ishte i angazhuar edhe në projektimin dhe zbatimin e procedurave të menaxhimit financiar për disa klientë. Zeka ka përvojë konsulence në fushën e raportimit financiar për disa projekte të Komisionit Evropian në Kosovë. Ai ishte pjesë e një ekipi të Bankës Botërore të angazhuar në vlerësimin e respektimit të standardeve dhe kodeve për Kosovën (raporti ROSC). Ai është anëtar i Komitetit të Standardeve Profesionale e Këshillit të Raportimit Financiar në Kosovë. Zeka është anëtar i Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK).



Lekë Musa – Partner

Musa është konsulent i taksave dhe standardeve të kontabilitetit dhe auditor i çertifikuar, ka dhjetë vjet përvojë në kontabilitet, si dhe ka marrë pjesë në krijimin e rregulloreve të kontabilitetit dhe tatimeve në Kosovë. Musa ka diplomë të MBA në sektorin e financës dhe të kontabilitetit nga Swedish University of Vaxjo. Musa është anëtar themelues i SHKÇAK nën kujdesin e Bankës Botërore dhe ka shërbyer si Presidenti i parë i SHKÇAK. Musa ka përvojë në mbikëqyrjen angazhimeve të auditimit të shumë organizatave joqeveritare që veprojnë në Kosovë, kompani tregtare në industri të ndryshme, në tregtinë me pakicë, të naftës dhe gazit, prodhimin e verës, industrinë e shërbimit.



Lulzim Berisha - Partner

Partner, është auditor i licencuar dhe kontabilist i certifikuar sipas rregulloreve të Kosovës. Berisha ka më shumë se dhjetë vjet përvojë në ofrimin e shërbimeve për klientët të ndryshëm në tregti me pakicë, në ndërtim, prodhim, prodhim të verës dhe industrive të tjera. Berisha ka shërbyer si anëtar i Bordit të Kosovës për Standardet e Raportimit Financiar, si organ mbikqyrës i pavarur për auditorët e licencuar në Kosovë.



Bashkim Uka - Partner

Auditor i licencuar, me më shumë se njëzet vjet përvojë të punës në kontabilitet sipas standardeve përgjithësisht të pranuar të kontabilitetit dhe të auditimit. Z. Uka është i pari në mesin e 13 auditorëve të licensuar që është licencuar nga autoritetet e UNMIK-ut. Z. Uka është anëtar i Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (SHKÇAK). SHKÇAK është anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilitetit (FNK) që nga viti 2003. Z. Uka ka shërbyer si President i SHKÇAK nga viti 2002-2005. Z. Uka ka shërbyer edhe si egzaminer bankar në Bankën Qendrore të Kosovës. Uka ka një përvojë të gjerë në ofrimin e auditimit dhe shërbime të këshillave për klientët në entitetet jo-fitimprurëse dhe fitimprurëse.



Petrit Zeka – Menaxher

Petriti ka mbi shtatë vjet përvojë në kontabilitet në tregtinë me pakicë, ndërtimit dhe industrisë së sigurimeve. Gjithashtu ai ka më shumë se pesë vjet përvojë në ofrimin e shërbimeve këshilluese për organizatat jo-fitimprurëse, hulumtim dhe marketing ekspertizë. Që nga viti 2008 kur Petriti u bashkua Baker Tilly Kosovo, ai ishte pjesë e angazhimeve të auditimit me organizatat jo-fitimprurëse si UNHCR, USAID dhe projektet e financuara nga BE. Para se të bashkohej me Baker Tilly Kosovo ai ka ofruar shërbime të kontabilitetit dhe shërbime të tjera këshilluese për organizatat jo-fitimprurëse.



Arbresha Tuhina – Menaxhere

Arbresha ka mbi pesë vjet përvojë në kontabilitet. Që nga viti 2011, kur u bashkua Arbresha me Baker Tilly Kosovo, ajo është pjesë e angazhimeve të kontabilitetit me klientë të ndryshëm. Para se ajo të bashkohej me Baker Tilly Kosovo ajo ka ofruar shërbime të kontabilitetit dhe shërbime të tjera të konsulencës për industrinë e telekomunikacionit.



Mbështetja kyçe e stafit

Arta Xhema – senior, advisory services

Blerim Gjoni – audit staff, senior

Altin Sahiti – audit staff, junior

Informacione të hollësishme në lidhje me ekipin

Emri: **Lulzim Zeka**
Data e lindjes: 15 Prill 1973
Kombësia: Kosovar, Shqipëtar

Edukimi

Institucioni: W.P. Carey School of Business, Arizona State University
Titulli ose diploma: Master i kontabilitetit

Kualifikimi profesional

Institucioni: Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës
Titulli ose diploma: Auditor i licencuar
Data kur iu bashkua firmes: Korrik 2005

Përvoja e punës

Institucioni: Baker Tilly Kosovo (ish- BU & Partners)
Titulli I punës: Asistent i auditorit dhe Partner në vazhdim
Datat: Korrik 2005 – në vijim
Përshkrimi I punës: Pjesëmarrja në ekipet e auditimit që kryejnë detyra të auditimit. Mbledhja e dokumentacionit të nevojshëm për një auditim. Mbështetja e udhëheqësit të ekipit, kur bëjnë një auditim. Prodhimi i raporteve të auditimit (ose pjesë e raporteve të auditimit) nën mbikëqyrjen e udhëheqësit të ekipit.

Institucioni: Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës
Job title: Shef i Departamentit Profesional
Datat: Janar 2003 – Qershor 2005
Përshkrimi I punës: Zhvillimi dhe implementimi i programit të certifikimit SHKÇAK. Përgatitja e planit të veprimit të departamentit profesional në bazë të objektivave të planit strategjik të SHKÇAK-së. Bashkëpunimi me palët relevante të tilla si universitetet, rregullatorët dhe agjencitë e tjera.

Institucioni: UN World Food Programme
Titulli I punës: Finance assistant
Datat: July 1999 – June 2002
Përshkrimi I punës: Përgatitja e dokumenteve të pagaesave dhe regjistrimi i transaksioneve në libra. Monitorimi i sistemit të barazimit të shpenzimeve, saldove, pagesave dhe raporteve tjera financiare. Arranzhimi i rimbushjes së parasë së vogël dhe autorizimi i saj. Kontrolli i buxhetit dhe shpenzimeve.

Përvoja specifike
Baker Tilly Kosovo

Titulli:

Përshkrimi:

Partner i angazhimit
I përfshirë në auditimin e klientëve në
industri të ndryshme:

Organizatat Qeveritare:

KUR Hidrodrini, Pejë 2014
Stacioni i Autobusëve, Gjakovë 2013
Stacioni I Autobusëve, Gjilan 2013 - 2014
KRM Cabrati, Gjakovë 2013
Ngrohtorja e Qytetit, Gjakovë 2010-2014
Drini I bardhë, Kompania e ujitjes Pejë
2010-2012

Për klientë fitimprurës:

Ledo LLC, Croatia 2009-2014
Meridian Corporation 2011-2014
Meridian Express 2013-2014
Kosova Foods BUKA – 2014
Limak Construction, Turkey 2012-2014
GBS Bulgaria 2012-2014
Vitaminka 2012-2014
Auto Mita 2013-2014

Organizatat jo-qeveritare

Agjencia Kosovare e Privatizimit –

Auditim i ndërrmarjeve të komercializuara -
2009

Organizatat jo-qeveritare

Mercy Corps Kosovo – Irish aid Project,
2007, Reconstruction and stabilization
project (UNDP funded project), 2007

Care International Kosovo – SRH project
funded by UNFPA, 2005, Sustainable sub-
urban returns funded by EAR, 2006, REGS
project 2007, START II project 2007

Olof Palme International Center – project i
financuar nga SIDA, 2007, 2008

Caritas Switzerland, 2005 - 2009

Intercooperation, Swiss project – 2005,
2006, 2007

Swisscontact, 2005-2009

American refugee Committee, projektet e
UNDP/GAR 2003-2005

OJQ tjera të vogla dhe projekte të
financuara nga donator

Emri: **Lekë Musa**
Data e lindjes: 16 Prill 1974
Kombësia: Shqipëtar, Kosovar

Edukimi

Institucioni: University of Vaxjo, Sweden
Titulli ose diploma: Master në Administrim Biznesi

Kualifikimi profesional

Institucioni: Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës
Titulli ose diploma: Auditor i Çertifikuar

Institucioni: Ministria e Financave
Titulli ose diploma: Vlerësues i pasurive të patundshme

Data kur iu bashkua firmes: Themelues 2005

Përvoja e punës:

Institucioni: Baker Tilly Kosovo (ish BU & Partners)
Titulli i punës: Partner
Datat: Janar 2001 – në vijim
Përshkrimi i punës: Menaxher i auditimit për angazhime të auditimit të klientëve fitimprurës dhe OJQ-ve. Specialist Trajnimi për menaxhimin e financave publike. Zhvillim Trajnimi programit për Zyrtarët e Sektorit Publik në vitin 2009 duke mbuluar tema nga Thesari, Buxhet, Raportim, një program që ka përfshirë më shumë se 300 zyrtar.

Institucioni: Telekom i Kosovës
Titulli i punës: Zëvendës Drejtor / Chief Executive Officer
Datat: 2007 - 2009
Përshkrimi i punës: Raportimi ndaj drejtorit menaxhues të PTK dhe drejtorit operativ të PTK. Zhvillimin i planeve dhe politikave operacionale për Telekomin e Kosovës.

Institucioni: Departamenti i shtetit ShBA, Zyra e ShBA në Prishtinë
Titulli i punës: Specialist ekonomik/l tregtisë
Datat: Prill 2001 – Shkurt 2007
Përshkrimi punës: Përgjegjës për raportim me kohë dhe të saktë për indikatorët ekonomik dhe ofrimi i këshillave për Shefin e Misionit dhe zyrtarët tjerë të Departamentit të Shtetit lidhur me qështjet ekonomike dhe të tregtisë në Kosovë.

Institucioni: Banka Botërore zyra në Prishtinë
Titulli i punës: Konsulent
Datat: 2000 -2001

Përshkrimi punës: Ka shërbyer si konsulent në projektin e Bankës Botërore për ti asistuar Qeverisë së Kosovës në projektin për draftimin e matricës për shpenzimet afatmesme për buxhetin e Kosovës.

Institucioni: Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Titulli I punës: Kryetar i Këshillit

Datat: 2001 -2002

Përshkrimi punës: Themelimi i ShkQAK me mbështetjen e Bankës Botërore dhe USAID-it

Përvoja specifike:

Baker Tilly Kosovo

Titulli I punës:

Përshkrimi:

Menaxheri i Auditimit
I përfshirë në auditimin e klientëve siç janë:

Organizatrat Qeveritare:

Stacioni i Autobusëve, Gjakovë 2013
KRM Cabrati, Gjakovë 2013
Ngrohtorja e Qytetit, Gjakovë 2010-2014

Për klientë fitimprurës:

Meridian Corporation 2011-2014
Meridian Express 2013-2014
Kosova Foods BUKA – 2014
Vitaminka 2012-2014
Auto Mita 2013-2014

Organizatrat jo-qeveritare

Danish Refugee Council, 2004 - 2009
Olof Palme International Center – projekte të financuara nga SIDA, 2007, 2008,2009
Caritas Switzerland, 2005 – 2009, 2011
Intercooperation, Swiss project – 2005, 2006, 2007
Swisscontact, 2005-2009
Foundation for Democratic Initiatives (FDI), 2006-2009
Regional Environment Center, Kosovo – 2004-2009,
Terre des Hommes, Kosovo – 2004-2009
KIPRED 2009-2012
OJQ-të tjera të vogla dhe projekte të financuara nga donatorët.

Emri: **Bashkim Uka**
Data e lindjes: 8 Janar 1956
Kombësia: Shqipëtar, Kosovar

Edukimi

Institucioni: Universiteti i Prishtines, Fakulteti Ekonomik
Titulli ose diploma: Diploma

Klasifikimi profesional

Institucioni: Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës
Titulli ose diploma: Auditor i Licencuar

Data kur iu bashkua firmes: Themelues 2005

Përvoja e punës:

Institucioni: Baker Tilly Kosovo (ish. BU & Partners)
Titulli i punës: Partner
Datat: Janar 2003 – në vijim
Përshkrimi i punës: Përgjegjës për auditimin e klientëve në biznes dhe OJQ.

Institucioni: IPKO
Titulli i punës: Drejtor Financiar
Datat: Qershor 2002 – Dhjetor 2007
Përshkrimi i punës: Udheheqja e financave të kompanise, perpilimi i pasqyrave financare të kompanise, etj.

Institucioni: Banka Qëndrore
Titulli i punës: Mbikqyrës bankar
Datat: 2002
Përshkrimi i punës: Mbikqyrja e bankave dhe aktiviteteteve të tyre

Institucioni: Payments authority (Ish Jugosllavia)

Titulli i punës: Public auditor

Datat: 1982 -1999

Përshkrimi i punës: Auditimi i kontabilitetit dhe pasqyrave financiare të ndërmarrjeve publike dhe private, bankave, kompanive të sigurimit etj. Mbikëqyrja dhe auditimi i të gjitha taksave të paguara nga firmat dhe ndërmarrjet. Raportim për gjendjen financiare të firmave.

Përvojat specifike:

Baker Tilly Kosovo

Titulli I punës:

Përshkrimi:

Partner për angazhimin

I përfshirë në auditimin e klientëve siç janë:

Organizatat jo-qeveritare

Mercy Corps Kosovo – Irish aid Project, 2007,
Reconstruction and stabilization project (UNDP
funded project), 2007

Care International Kosovo – SRH project funded
by UNFPA, 2005, Sustainable sub-urban returns
funded by EAR, 2006, REGS project 2007,
START II project 2007

Danish Refugee Council, 2004, 2009 - 2012

Olof Palme International Center – SIDA funded
projects, 2007, 2008

Caritas Switzerland, 2005 – 2009, 2011

Intercooperation, Swiss project – 2005, 2006,
2007

Swisscontact, 2005-2009

OJQ-të tjera të vogla dhe projektet e financuara
nga donatorët.

Emri: **Lulzim Berisha**
Data e lindjes: 8 Mars 1976
Kombësia: Shqipëtar, Kosovar

Edukimi

Institucioni: Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Ekonomik
Titulli ose diploma: Diploma

Kualifikimi profesional

Institucioni: Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës
Titulli ose diploma: Auditor I licencuar

Institucioni: Ministria e Financave
Titulli ose diploma: Vlerësues i pasurive të patundshme

Data kur iu bashkua firmës: 1 Maj 2008

Përvoja e punës:

Institucioni: Baker Tilly Kosovo (ish. BU & Partners)
Titulli i punës: Partner
Datat: Maj – 2008, në vijim
Përshkrimi i punës: Përgjegjës për auditimin e klientëve në biznes dhe OJQ

Institucioni: Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës
Titulli i punës: Trajner dhe zhvillues biznesi
Datat: Qershor 2003 – Dhjetor 2007
Përshkrimi i punës: Ligjerimi i lëndëve të ndryshme si pjesë e programit çertifikues të SCAAK. Zhvillimi dhe formulimi i materialeve të trajnimit profesional në lëndët: Kontabiliteti financiar, kontabiliteti i kostos, sistemet e menaxhimi të informatave , rregulloret komerciale, auditimi, studime rasti, standarde te kontabilitetit

Institucioni: QMI
Titulli i punës: Menagjer i Financave
Datat: Shtator 2002 – Qershor 2003
Përshkrimi i punës: Përgatitja e planeve të biznesit, përgatitja e pagesave dhe regjistrimi i transaksioneve në libra. Monitorimi i sistemit të shpenzimeve, saldove, pagesave dhe transaksioneve tjera.

Përvojat specifike:

Baker Tilly Kosovo

Titulli i punës:

Përshkrimi:

Partner për angazhimin

I përfshirë në auditimin e klientëve siç janë:

Organizatrat Qeveritare:

Stacioni i Autobusëve, Gjilan (2013-2014)

Drini i bardhe, Kompania ujitjes (2010-2012)

Organizatrat jo-qeveritare:

Asociacioni i Institucioneve Mikrofinanciare të

Kosovës (AMIK) – 2008

Caritas Switzerland, 2008, 2009

Klientët Biznesor:

KAG Asphalt – 2008-2014

Victoria Invest International 2011 – 2014

Ilir Canon Kosova, Prishtine, wholesale and
retail business 2007-2014

Marigona Residence 2012 -2014

Remateks 2012-2014

NewKo Ballkan LLC. 2011-2014

Benaf – 2008-2011

Alcatel Italy, 2006 - 2008

Intercooperation, Swiss project – 2005, 2006,
2007

Drini Company, 2008-2011

Kompani tjera të vogla

Emri: **Petrit Zeka**
Data e lindjes: 1 Shtator 1982
Kombësia: Kosovar, Shqipëtar

Edukimi:

Institucioni: Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Ekonomik
Titulli ose diploma: i diplomuar në Financa dhe Kontabilitet

Klasifikimi profesional:

Institucioni: Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës
Titulli ose diploma: Teknik i Kontabilitetit

Data kur iu bashkua firmës: Maj 2008

Përvoja e punës:

Institucioni: Baker Tilly Kosovo (BU & Partners)
Titulli i punës: Auditor Junior dhe menaxher në vazhdim
Datat: Maj 2008 – në vijim
Përshkrimi i punës: Pjesëmarrja në ekipet e auditimit për kryerjen e auditimeve. Grumbullimi i dokumenteve të nevojshme për auditim. Mbështetja e udhëheqësit të ekipit kur kryen auditime. Përgatitja e raporteve ose pjesëve të raportit nën mbikqyrjen e udhëheqësit të ekipit.

Institucioni: Shoqata e sigurimeve të Kosovës
Titulli i punës: Shef i kontabilitetit
Datat: Korrik 2006 – Maj 2008
Përshkrimi i punës: Përgatitja e raporteve vjetore në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit, përfshirë rezervat teknike për dëmet e pagueshme. Mbikqyrja e pikave kufitare për çështjet financiare Raportimi para bordit të drejtorëve mbi shpenzimet aktuale kundërjet atyre të buxhetuara. Lidhje në mes të IAK dhe bankës Qendrore për çështjet financiare. Përgjegjës për organizimin e auditimit vjetor

Institucioni: INDEX Kosova
Titulli i punës: Menaxher i DP/financiar
Datat: Qershor 2004 - Nëntor 2005
Përshkrimi punës: Menaxhimi i parasë Përgatitja e rrogave për personelin, përfshirë llogaritjen e tatimeve dhe kontributeve pensionale në pajtueshmëri me ligjet aktuale në Kosovë. Përgatitja e buxheteve për të gjitha projektet Pagesat e tatimeve dhe çështje tjera relevante me autoritetet tatimore Përgatitja e pasqyrave financiare sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit.

Përvoja specifike:

BU & Partners

Titulli i punës:

Përshkrimi:

Auditor Junior dhe menaxher më pas
Organizatat qeveritare
Agjencia Kosovare e Privatizimit – Auditim
I ndërrmarjeve komerciale - 2009

Organizata jo-qeveritare
UNHCR Implementing partners (DRC,
ICMC, Mercy Corps, NCA, CRPK, DT),
2008
Olof Palme International Center – SIDA
funded projects, 2008
Caritas Switzerland, 2008
Swisscontact, 2008
AMIK, 2008
Swiss Labour Assistance, 2008
Caritas Luxembourg, 2008
FDI, 2008
OJQ-të tjera të vogla dhe projektet e
financuara nga donatorët

Emri: Arbresha Tuhina
Data e lindjes: 13 Maj 1980
Kombësia: Kosovare, Shqipëtare

Edukimi

Institucioni: Universiteti I Prishtinës, Fakulteti Ekonomik
Titulli ose diploma: Diploma
1997-1998 "Enid High School", Oklahoma, USA - Graduate
1994-1997 "Sami Frashëri" High School, Prishtinë

Klasifikimi profesional

Institucioni: Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës
Titulli ose diploma: Teknik i Kontabilitetit, një provim i mbetur për titullin Kontabiliste e Çertifikuar

Data kur iu bashkua firmës: Prill 2011

Përvoja e punës

Institucioni: Baker Tilly Kosovo (ish BU & Partners)
Titulli I punës: Konsulente e Lartë
Datat: Prill 2011 – në vijim
Përshkrimi punës: Përgjegjëse për përgatitjen e pasqyrave financiare të klientëve në industri të ndryshme
Komunikim me klientët
Ndhmon në zhvillimin dhe zbatimin e procedurave të reja dhe karakteristikave për të përmirësuar rrjedhën e punës së departamentit
Përgjegjëse për të mbikëqyrur personelin e ri

Institucioni: IPKO Foundation
Titulli I punës: Shefe e Financave dhe Administratës
Datat: Prill 2001 – Pril 2011
Përshkrimi i punës: Monitorim pajtueshmërinë e përfituesve të bursave me kushtet e dhënies - kontrolloni notën mesatare e tyre dy herë në vit
Të ndihmojë menaxherin e programit për t'u përgatitur për mbledhjen e bordit dhe juris Mbikëqyrë auditime dhe raportim në zyrën e OJQ-ve

Institucioni: IPKO Telecommunication
Titulli I punës: Kontabiliste
Datat: Qershor 2008 – Mars 2011
